



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupšina Opštine Orahovac / Municipal Assambly Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e pestë e Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e mbajtur sot, më datë **30.12.2025 (e martë)**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e komitetit, **Samra Kërçagu**. Të gjithë anëtarët e komitetit ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Përgatitja e Planit të Punës të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2026;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesja: Mirëmëngjesi! Përshëndetje për të gjithë! Jemi mbledhur sot, për ta mbajtur edhe takimin e fundit të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2025. Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës. Atëherë, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim! Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesja: Atëherë, nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është pro? Unanimisht aprovohet edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Përgatitja e Planit të Punës të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2026:

Kryesuesja: Atëherë, ne veçse e kemi përgatitur një draf-plan, me të cilin synojmë ta fillojmë vitin 2026 dhe në secilën mbledhje të komitetit t’i diskutojmë gjërat e parapara në këtë plan.

Selman Shtavica: Përshëndetje për të gjithë! Një çështje që duhet të involvohet në këtë plan është çështja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. P.sh. në Krushë të Madhe janë katër të punësuar. Sipas ligjit, në çdo 51 persona duhet të jetë i punësuar një nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesja: Po, ide shumë e mirë dhe mund ta vendosim si kërkesë këtu në plan.

Atdhe Rama: Planin mund ta ndryshojmë në disa specifika të vogla. Mund ta shtojmë si opSION edhe takimin me komitete të komunave të tjera.

Kryesuesja: Po, mund ta shtojmë edhe këtë propozim. Unë e kam edhe një propozim tjetër, rreth asaj që do të ishte mirë merremi pak me shtesat e personave me aftësi të kufizuara. Shtesat t’i marrin me rregull dhe ata që nuk i marrin, me ndonjë kërkesë ne si komitet t’ju dalim në ndihmë.

Atdhe Rama: Kjo është një ide shumë e mirë. Bashkërisht mund ta bëjmë ndonjë fushatë sensibilizuese për këtë çështje në pranverë.

Kryesuesja: Faleminderit! A keni ndonjë ide për aktivitetet e 3 dhjetorit?

Atdhe Rama: Në bashkëpunim me drejtoritë e komunës dhe me organizata të tjera mund t’i planifikojmë disa aktivitete sportive.

Selman Shtavica: Mundësisht, aktivitetet sportive të bëhen në palestër, sepse është mjaft ftohtë.

Nashide Shehu: Pajtohem edhe unë. Paraprakisht duhet të merremi vesh që në palestër të ketë kushte për mbajtjen e këtyre aktiviteteve. Sa e di unë, palestra ka edhe ngrohje të sallës.

Kryesuesja: Faleminderit! Po, do të ishte një ambient i ngrohtë për të gjithë! Ideja është që t'i involvojmë edhe lojtarët seniorë të ekipeve tona të Rahovecit dhe ta bëjmë më interesant aktivitetin.

Ferat Durguti: Faleminderit kryesuese! Sa i përket çështjes së tryezës. Unë propozoj që këtë tryezë ta organizojmë në muajin janar, me qëllim që jetë një fillimvit i mirë dhe të jemi të informuar më shumë rreth kategorisë së personave me aftësi të kufizuara. Paraprakisht, tryeza duhet të ketë njerëz kompetentë të fushës.

Atdhe Rama: Zakonisht jemi takuar me OJQ të ndryshme, kemi diskutuar dhe iu kemi treguar rreth kushteve tona, njëkohësisht edhe u kemi kërkuar gjëra të nevojshme për këtë kategori.

Selman Shtavica: Për ndihma të ndryshme është shumë mirë të bashkëpunojmë edhe me Hendikosin e Suharekës, sepse janë shumë korrektë në punë.

Atdhe Rama: Na jemi komitet konsultativ dhe jo Hendikos. Të këshilloj ty, që prej pozitës që e ke aty, t'u kërkosh atyre ndonjë ndihmë dhe të bësh takime të shpeshta si dy organizata që jeni.

Kryesuesja: Ju falënderoj shumë për angazhimin! Nëse nuk keni ndonjë gjë tjetër, kalojmë te pika e fundit!

3. Të ndryshme:

Atdhe Rama: Faleminderit! Krejt në fund, na mbetet që t'i vendosim në plan edhe gjërat që sot i folëm dhe në mbledhjen e parë të janarit ta votojmë planin. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin.

Kryesuesja: Gjithashtu edhe unë ju falënderoj dhe shihemi në mbledhjen e radhës. Urime festat e fundvitit.

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi

Kryesuesja e komitetit


Samra Kërqagu

